



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 17.06.2013
Nr. 0204-753

PËR: Haki Rugova, Kryetar i Komunës së Isogut
Demë Çeta, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË
ISTOGUT, 01 Nr. 26 /2013 , Pranuar me datë, 11.06.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 Nr. 26/2013 të miratuar me datë 31.05.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01 Nr. 26 /2013, jepet pëlqimi dhe miratohen tarifat për grumbullimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Istogut.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 17.06.2013
br. 0204-753

Za: Haki Rugova, Gradonačelnik opštine Istok
Demë Çeta, Predsedavajući Skupštine opštine Istok

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Isatok, 01 br. 26/2013, primljeno dana, 11.06.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01 br. 26/2013 **odobreno dana 31.05.2013, POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi.



Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je, kao što sledi,

- Odluka 01 br. 26 /2013, daje se saglasnost i usvajaju se cene za prikupljanje otpada u teritoriji oštine Istok.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.

 Republika e Kosovës Republikka Kosovo Republic of Kosova	KUVENDI I KOMUNËS SKUPSTINA OPSTINE		 Komuna e Istogut Opstina Istok Istog Municipality
	01 Nr.26/2013	Data: 31.05.2013	

Kuvendi i Komunës së Istogut, në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28/2008) në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2013, shqyrtoi tarifat për grumbullimin e mbeturinave të parashtruara nga Ndërmarrja komunale "Ambienti" sh.a. me seli në Istog dhe mori këtë:

V E N D I M

- I. Jepet pëlqimi dhe miratohen tarifat për grumbullimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Istogut, të paraqitur nga Ndërmarrja Publike Komunale "Ambienti" sh.a. me seli në Istog si në vijim:

Kategoritë e konsumatorëve	Grupi dhe zonimi i konsumatorëve	Tarifa për Konsumatorë me njësi matëse €/pa TVSH	TVSH	Tarifa për Konsumatorë me njësi matëse €/me TVSH
Shtëpiakë	Derë për derë	3.45	0.55	4.00
	Me kontejnerë	3.45	0.55	4.00
Komerzial/ Industrial	Nën kategoria e I-rë zona e I-rë	5.00	0.80	5.80
	Nën kategoria e II-të zona e I-rë	8.62	1.38	10.00
	Nën kategoria e IV-ërt zona e I-rë	15.52	2.48	18.00
Komerzial/ Industrial me Kontratë dhe kontejnerë të veçantë	Kontejnerët 1.1 m ³ , një zbrazje	11.21	1.79	13.00
	Kontejnerët 7 m ³ , një zbrazje	35.00	5.00	40.00

- II. Sipas Rregullatorit Subjektet-Bizneset të cilët marrin sipas kontratës kontejnerët 1.1 m³, janë të obliguar që ti paguajnë (pa marrë parasysh zbrazjet) 39.00 euro, që u pranohen si tri zbrazje plus.
- III. Pagesa e tarifave, nga bizneset do të bëhet sipas kategorizimit si në vijim:
- a) Kategoria e parë ku përfshihen: kioskat, kafe pjekëse-shitore, shitës të cd-ve dhe kasetave, argjendari, orëtar, agjenci turistike, avokatura, video lojëra, video klub, internet kafe, rrobaqepës, këpucëtarë, fotograf, pastrim kimik, kozmetika, optika, gurrë gdhendës, mbathtarë, zyra e arkëtimit, përfaqësi të shoqatave, objekte fetare, shitore suvenirësh, këmbimore e të ngjashme;
 - b) Kategoria e dytë ku përfshihen: butik, librari, autolarje, auto parking, bastore, kurse të gjuhëve dhe IT, frizer meshkujsh dhe femrash, podrum të pijeve, byrektore, ëmbëltore, shitore tekstili, auto pjesë, hekurishte, shitore e sanitarisë, shitore të mobileve, shitore këpucësh, mishtore e specializuar, servise të ndryshme, zyra të partive politike, farmaci, ambulancat me orar të shkurtuar, zyrat postare e të ngjashme;
 - c) Kategoria e tretë ku përfshihen: bizneset në raste konkrete sipas kapacitetit të punës dhe largësisë nga qendra-zona e parë e qytetit, periferia dhe fshatrat si: shitore ushqimore, gjellëtore, kafiteri, ambulanca, etj.
 - d) Kategoria e tretë ku përfshihen: furra të bukës, kafiteri, gjellëtore, shitore ushqimore, ambulancat private (të gjitha llojet të cilat punojnë me orar të plotë), xhamaprerës, ekspozitura bankare, sallone të sanitarisë, sallone mobilie, qendrat sportive e të ngjashme.
- IV. Zbatimi i tarifave të miratuara në këtë vendim do të fillojë nga 01 qershor i viti 2013.
- V. Për zbatimin e këtij Vendim do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Ndërmarrja Publike Komunale "Ambienti" sh.a..
- VI. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.
- VII. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Ndërmarrja Publike Komunale "Ambienti" sh.a. dhe një kopje në arkivin e kuvendit.


Kryesuesi,
Dimitër Çeta